



NEON A.S
RR.XHANFISE KEKO, Nd.168 , H.1, CP. 1005
TIRANA, ALBANIA
TEL: +355 42 377 773 FAX:: +355 42 347 770
E-MAIL: info@neon.al WEB: www.neon.al

**NEON UNO PLASTIC
(UNO PLASTIKE)
BOJE PËR LYERJE MURI
Skedë Teknike**

PËRSHKRIMI: UNO PLASTIC është një bojë bardhë e pregatitur nga një emulsion i tipit “polimer (PVA-VEOVA) në ujë” e destinuar për lyerje muri të brendshëm, që përveç rezinave dhe ujit përmban në përqindje të caktuara mbushës, pigmente e shtesa të tjera sikurse janë dioksid titani, karbonat kalciumi, heksametafosfat natriumi, hidroksietilcelulozë, izotiazolinon, poliksiloksane, poliakrilat amoni, hidroksid kaliumi, të cilët përmirësojnë vetitë e bojës. Referuar përbërësve të saj, në kushte optimale boja thahet 3 - 4 orë pas aplikimit, duke formuar një cipë plastike , e cila ka rezistencë të lartë ndaj fërkimit dhe qëndrueshmëri ndaj dritës dhe ujit. Dy javë pas bojatisjes sipërfaqja mund të pastrohet me leckë të njomë.

FUSHA E PËRDORIMIT: UNO PLASTIC është e përdorshme në mjedise të brendshme, për bojatisjen e sipërfaqeve të suvatuara ose sipërfaqeve prej betoni.

NGJYRA: E bardhë.

PARAPËRGATITJA: Sipërfaqja që do të bojatiset, duhet të pastrohet nga pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës, të lidhura dobët me sipërfaqet (shtresat e fryra). Në sipërfaqet e reja duhet të kalohet paraprakisht një dorë astari plastik PN – 301 i cili hollohet me ujë deri në masën 30% ose me astar plastik PN – 101 i cili është i gatshëm për përdorim.

PËRDORIMI: Përgatitet boja duke shtuar ujë deri në konsistencën e kërkuar. Për të realizuar një lyerje të mirë, duhet të aplikohen dy duar UNO PLASTIC. Për dorën e parë hollimi i bojës me ujë duhet të jetë në masën 15-20%. Ndërsa për dorën e dytë e cila aplikohet pasi të jetë tharë plotësisht dora e parë, hollimi me ujë bëhet deri deri në masën 10%. Doza e pigmentit që mund të përdoret, është sipas rekomandimit të prodhuesit. Lyerja aplikohet lehtësisht me rrul ose furçë.

NGJYRIMI: UNO PLASTIC është e përshtatshme për të krijuar një gamë të gjërë bojrash me ngjyrë, duke përdorur 9 bazat ngjyruese NEON UNO COLOR PAINT dhe 9 bazat ngjyruese NEON RS COLOR PAINT, si dhe ngjyrimin nëpërmjet dozimit sipas sistemeve kompjuterike me 16 ngjyra.

KUJDES: Nuk lejohet aplikimi i bojës në sipërfaqe të njoma dhe në kushte të larta lagështie të mjedisit. Nuk rekomandohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 5⁰C. Pas përfundimit të lyerjes paisjet duhet të lahen menjëherë me ujë dhe sapun.

TE DHENAT TEKNIKE:

- Ngjyra.....E bardhë
- Imtësia.....5 – 25 µm
- Viskoziteti (30% ujë) Deep Cup 4.....25 – 40 sek
- Densiteti.....1.58 – 1.6 g/ml
- Fuqia mbuluese për lyerje të plotë.....7 – 8 m²/L
- Mbetja e thatë.....≤ 64 %
- Koha e tharjes.....3 - 4 orë

REZIKSHMËRIA: Bojrat me bazë ujore të “NEON sh.a” kanë përbërës që nuk klasifikohen si të rrezikshëm mbështetur në Direktivën 1999/45/EC. Megjithatë kontakti me acidet dhe në temperatura mbi 800⁰C, bën që të çlirohet dioksid karboni.

AMBALAZHIMI: Ambalazhimi bëhet në kova plastike 0.75L, 3L, 9L dhe 15L.